

URDHËR
Nr. 369 datë 19.9.2019

PËR HAPJEN E THIRRJES SË DYTË PËR APLIKIME PËR PROGRAMIN IPARD II
(ndryshuar me urdhrin nr. 498, datë 4.12.2019)

Mbështetur në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, në Marrëveshjen Kuadër, Marrëveshjen Sektoriale për IPARD II dhe Marrëveshjen e Financimit,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e thirrjes së dytë për aplikime nga Programi IPARD II, për aplikimet, respektimin e kërkesave për informimin, publicitetin dhe transparencës, me qëllim garantimin e vizibilitetit dhe llogaridhënien e fondeve të BE-së.

2. Të gjitha palët e interesuara janë të lutura të marrin informacionin e duhur në Udhëzuesin për Aplikantët lidhur me llojet e investimeve të pranueshme, aplikantët e pranueshëm, kriteret e përzgjedhjes dhe rregullat e dorëzimit të aplikimeve, i cili mund të kërkohej si një kopje e printuar (falas) në zyrat e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) gjatë orëve të punës 08:00–16:30.

3. Gjithashtu, Udhëzuesi për Aplikantët dhe formatet zyrtare të dokumenteve që duhet të përdoren (formulari i aplikimit, plani biznesit) mund të shkarkohen në versionin zyrtar nga faqja e internetit: www.azhbr.gov.al dhe <http://www.bujqesia.gov.al>.

4. Shtyhet afati për aplikime për thirrjen e dytë për aplikime nga programi IPARD II deri në datën 15 janar 2020. Çdo aplikim që vijon pas datës 15.1.2020 do të refuzohet.

5. Të gjitha aplikimet duhet të dorëzohen vetëm në zyrat qendrore të AZHBR-së në zarfe të mbyllura me titullin thirrje për dorëzimin e aplikimeve, së bashku me titullin e masës, emrin e plotë dhe adresën e aplikantit dhe me shënimin “Të mos hapet përpara dorëzimit”.

6. Aplikimet duhet të dorëzohen ose:

- nëpërmjet dërgesës postare rekomandë; ose
- dorazi (duke përfshirë shërbimet korierë) direkt në Autoritetin Kontraktues në këmbim të një mandati dorëzimi me firmë dhe datë nga: Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Rruga “Muhamet Gjollesha”, nr. 56, Tiranë, Shqipëri.

Aplikimet e dërguara nëpërmjet çdo mënyre tjetër (p.sh. me faks apo e-mail) apo të dërguara në adresë të tjera do të refuzohen.

Ky urdher hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTORE E PËRGJITHSHME
Frida Krifca